



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12 dhe 28 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 7 par. 4 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 6 nënparagrafi 1.7 të Rregullores nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal si dhe neneve 16 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.04.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR MIRATIMIN E NISMËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR HYRJE NË**  
**BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL**

**Neni 1**

I. **MIRATOHET**, Nisma e Kryetarit të Komunës së Lipjanit , Nr.020/01-17913 e datës 12.04.2023, për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal.

II. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunat si në vijim:

- 2.1 Komunës së Lipjanit
- 2.2 Komunës së Prishtinës –Kryeqytetit të Kosovës
- 2.3 Komunës së Podujevës
- 2.4 Komunës së Fushë Kosovës
- 2.5 Komunës së Obiliqit, dhe
- 2.6 Komunës së Graçanicës

III. Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me komunat për përgaditjen e Propozim –Marrëveshjes për bashkëpunimin ndërkomunal.

IV. Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Nr. 15-016/01-22369

Lipjan, më 31.03.2023

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

Kryesuesi i Kuvendit  
**Daut Azemi**

*Daut Azemi*

